



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ÇËRRIK

Cërrik 11.11.2024

**NJOFTIM**

**Për**

**shpalljen e konkursit të hapur, për të operuar në linjat e rregullta qytetëse dhe rrethqytetëse të udhëtarëve**

Në zbatim të nenit 8, pika2, të nenit 9, pika1/1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 23, pika 6, neni 54, shkronja “k”, nenit 55,pika2 dhe 6 të Ligjit Nr,139/2017, datë 17.12.2015 ‘Për Vetqeverisjen Vendore, Neni 8, neni 121,pika1, neni 125 dhe 126, pika 1 të Ligjit Nr,8485, datë 12.05.1999’Kodi I Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, I ndryshuar, Ligjit Nr 8378, datë 22.07.1998 ‘Kodi i Rrugor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Neneve 12,14,15,17,19 të Ligjit Nr 8308, datë 18.09.1998’Për transportet rrugore”, I ndryshuar, Udhëzimin Nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe Procedurat e Lëshimit të Lishncave, Autorizimeve dhe Certifikatave për ushtrimin e Veprimtarise në Transportin Rrugor, Udhëzimin Nr.12, datë 19.07.2007 “Për Përcaktimin e Numrit të Autoveturave Taksi, Shtypjen dhe Emetimin e Licencave, Bllokut të Udhëtimit dhe Regjistrimit të Shërbimit Taksi I ndryshuar me Udhëzimin Nr. 4, datë 25.04.2008, Bashkia Cërrik ka nisur Procedurat për zhvillimin e konkurimit të hapur të transportit të udhëtarëve për linjat e rregullta qytetëse dhe rrethqytetëse të udhëtarëve.

Kriteret e përgjithshme dhe të domosdoshme si më poshtë

1. Subjekti të jetë subjekt I tatueshëm pranë Bashkisë Cërrik.
2. Subjekti të ketë reputacion të mire.
3. Subjekti të ketë qëndrueshmërinë e duhur financiare.
4. Subjekti duhet të ketë kapital të mjaftueshëm. Subjekti duhet të ketë kapital të vlefshëm dhe rezervë gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të veprimtarisë, të një shume të barabartë me ose që tejkalon shumën e përgjithshme të 140.000 (njëqind e dyzet mije) leke për mjetin e parë dhe 70.000 (shtatëdhjetë mijë) lekë për cdo mjet tjetër në përdorim.
5. Subjekti duhet të ketë në zotërim Certifikatën e Kopetencës Profesionale nga pronari/administratori ose drejtuesi teknik I veprimtarisë së subjektit I kontraktuar

për këtë qëllim, sipas kritereve përkatëse lidhur me numrin e mjeteve që menaxhohen.

6. Subjekti duhet të ketë si objekt të veprimtarisë së tyre transportin e udhëtarëve.
7. Subjektet duhet të kenë në dispozicion mjete të mjaftueshme për të ofruar shërbimin dhe çdo vit të përmirësojnë flotën e tyre me 30% me kushtin që vit prodhimi I tyre të jetë më I ri se mjetet e flotës aktuale.
8. Subjektet duhet të kenë Agjensinë e tyre në vende të përcaktuara në nisje dhe kthim.

### **Dokumentacioni I nevojshëm**

1. Kërkesa e aplikantit, e cila duhet të përmbajë, llojin e veprimtarisë që kërkon të kryejë dhe adresën e plotë të selisë/filialit, numrin e telefonit, faksit, email etj.
2. Akti I themelimit dhe statusi, ku specifikohet transporti I udhëtarëve si fushë e ushtrimit të veprimtarisë (për personat juridik që do të marrin pjesë në konkursin e hapur).
3. Operatori duhet të jetë I regjistruar në regjistrin përkatës profesionale ose tregtarë të shtetit dhe paraqet kopje të ekstraktit mbi Historikun e Subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit I cili duhet të vërtetojë se:
  - a. Subjekti nuk është në proces falimentimi.
  - b. Subjekti nuk është I dënuar për shkelje penale.
4. Një dokument që vërteton se kapitalet/asetet e subjektit tuaj nuk janë në në duart e përmbaruesit gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to, lëshuar nga Zyra e përmbarimit.
5. Një dokument që vërteton se subjekti nuk ka kryer shkelje serioze të ligjeve të transportit, Kodit Rrugor, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të transportit Rrugor.
6. Deklaratë të mbajtur para noterit që merr përsipër plotësimin e parametrave tekniko-ekonomik të përcaktuara nga autoriteti licensues, në rast të shpalljes fitues.
7. Programi vjetor ekonomik-financiar dhe I zhvillimit të veprimtarisë për biznesin që parashikohet të ushtrohet.
8. Dokumentacion që vërteton zotërimin e kompetencës profesionale dhe eksperiencës, kontratën e punës, të lidhur përpara noterit, me kohëzgjatje të paktën pesëvjeçare me drejtuesin teknik të veprimtarisë, që plotëson kërkesën për kompetencë profesionale për raste kur kjo nuk plotësohet nga administratori ose pronari/pronarët e shoqërisë, si dhe dokumentacionin që vërteton eksperiencën të ngjashme në këtë fushë, Bashkëlidhur paraqitet gjithashtu edhe deklarata noteriale e të punësuarit të pajisur me CKP lidhur me numrin e mjeteve që menaxhohen.
9. Formularin e vetdeklarimit të gjëndjes gjyqësore për drejtuesin e veprimtarisë dhe administratorin e saj.
10. Liste me targat e automjeteve që do të përdorë në formë katalogu fotografik ku prezantohet
  - a. Kapaciteti transportues 8+1.
  - b. Paraqitja e jashtme.
  - c. Paraqitja e brendshme.
  - d. Përshtatshmeria e autobuzeve ndaj personave me aftësi të kufizuar.

- e. Numri I dyerve.
- f. Raporti I vendeve ulur ndaj atyre në këmbë.
- g. Mjetet e informimit dhe komunikimit.
- h. Lejet e qarkullimit.
- i. Referenca dhe çdo dokument tjetër që kërkohet sipas standarteve të linjës të përcaktuara në urdhërin përkatës apo legjislacionin në fuqi
  - 11. Deklaratë që mjetet që do të ofrohen shërbimi nuk janë të përfshira në ndonjë tjetër aktivitet por do të jenë në dispozicion vetëm për shërbimin e transportit qytetës apo rrethqytetës në Bashkinë Çërrik.
  - 12. Deklaratë që pranojnë kushtin që mjetet e tyre nuk do të ndalojnë për të marrë udhëtarë në hapsirën territoriale të një linje tjetër.

#### Inventari i mjeteve

Subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë pranë Bashkisë Çërrik dokumentacionet e kërkuara në rrugë zyrtare pranë zyrës së protokollit ose dorazi në institucion. Afati përfundimtar I dorëzimit të dokumentacionit është 10 (dhjetë) ditë nga data e shpalljes.

Dokumentacioni i paraqitur pas këtij afati nuk do të merret në shqyrtim

Kushtet teknike të komoditetit dhe sigurisë të jenë si më poshtë:

1. Transporti rrethqytetës I udhëtarëve të bëhet me mjete të destinuara për transport udhëtarësh, me numër vendesh ulur dhe në këmbë të përshtatshme për transport rrethqytetës.
2. Mjetet duhen të jenë të pajisura me dritare emergjence funksionale. Pozicioni dhe mënyra e përdorimit të tyre ti bëhet e njohur udhëtarëve, nëpërmjet mbishkrimeve mbi to. Dyert e shërbimit të jenë me hapje të komanduar nga shoferi në mënyrë automatike.
3. Në dyer duhet të jenë të shënuara mbishkrimet e orientimit Hyrje, Dalje. 100% e mjeteve të inventarit do të jenë të pajisura me kondicionim.
4. Estetika e brendshme që konsiston në drejtim të një paraqitjeje dhe mirëmbajtjeje sa më të pranueshme e cila respekton në këtë mënyrë kërkesat e komoditetit për një shërbim të një cilësie do të jetë e detyrueshme për të gjitha mjetet. Estetika e jashtme e të gjitha mjeteve do të jetë e tillë që të plotësojë rregullat në zbatim të Kodit Rrugor lidhur me vendndodhjen mbi mjetet e transportit të shkrimeve a shenjave reklamuese të shndritshme ose reflektuese, me qëllim që të përjashtohet çdo rrezik verbimi a hutimi për drejtuesit e mjeteve të tjera dhe njëkohësisht të pengojë çdo formë reklamimi që ka një përmbajtje domethenie apo synim të kundërt me normat e këtij Kodi.
5. Dritaret duhet të jenë funksionale dhe të mos zihen si reklama. Të jenë të pajisur me kuti të ndihmës së shpejtë.
6. Mjeti të ketë shënimin Bashkia Çërrik si dhe stemën.
7. Ngjyrat e mjeteve të një linje duhet të jenë uniformë dhe të ndryshme nga linjat e tjera.

8. Operatorët duhet të marrin masa që çdo vit të përmirësojnë flotën e tyre me autobuza të rinj. Autobuzët e ri duhet që të kenë patjetër vit prodhimi më të ri se ata të flotës që operojnë.
9. Mjetet duhet të jenë të pajisur me kondicionim.
10. Mjetet të jenë të pajisur me matës shpejtësie të kolauduar sipas kërkesave ligjore (taograf).
11. Mjetet duhet të përmbushin dhe kërkesat sipas standarteve të BE për emetimin e gazrave dhe nivelin e ndotjes.

Vlerësimi I aplikantëve

Vlerësimi do të kryhet sipas procedurës së pikëzimit ku parasysh do të merren:

Eksperiencia në punë

Reputacioni I mirë

Mesatarja e vitit të prodhimit të mjetit.

Bashkia ka të drejtën e verifikimit në vend të plotësimit të specifikimeve teknike të lartpërmendura. Mosplotësimi I njërit prej tyre sjell ndërprerjen e procedurës së licensimit dhe vazhdimin e saj me kandidatin e renditur I dyti në klasifikimin e aplikantëve pjesëmarrës në konkurim.